



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



12 Nr. 060/p1-63509 dt. 30/10/2019

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 22.10.2019, ora 10⁰⁰.
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Gani Podrimqaku, Blerina Gashi, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin, Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, drejtorë të drejtorive Lumniye Krapë dhe Shyqiri Bublaku.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 30.08.2019.
2. Propozim Vendim për miratimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE – së) 2019 – 2021.
3. Raporti financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar- Shtator 2019.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Besoj a jeni për këtë rend të ditës. Atëherë vijojmë me pikat e rendit të ditës, pasi nuk ka diskutime, vërejtje, apo sugjerime kalojmë në aprovimin e Rendit të ditës. Votojmë; 7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. *Miratohet.*

Kalojmë tek Pika e parë; Proces verbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 30.08.2019 kaluar. E hapim për diskutim. Meqë nuk ka diskutime kalojmë në votim Votojmë; 7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. *Miratohet.*

Kalojmë tek pika 2 Propozim Vendim për miratimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE – së) 2019 – 2021. Është një material që drejtoria mund të na e japë në pika të shkurtra. Fjala për drejtoreshën.

Drejtoresha e drejtorisë për shërbime publike Lumnije Krapë; Përpara vetes e keni një projekt-propozim, i hartuar nga grupi punues dhe që është i mbështetur nga GIZ-i. Pra plani i veprimit të eficiencës të Energjisë Efiçiente është një dokument që analizon situatën aktuale dhe rekomandon për veprimet e ardhshme lidhur me sektorë të ndryshëm që lidhen me konsumimin e energjisë. Ky draft dokument që do të kalojë në Kuvend mbështetur në nenin 6 të ligjit 06L 07 për Eficiencë të Energjisë, ti cili vlen për të gjitha komunat, të cilat janë të obliguara ta kenë këtë draft ligj. Ky Draft ligj është një dokument mjaft voluminoz, ne e kemi dërguar edhe përmes emailit dhe nuk e di nëse e keni lexuar. Janë qëllimi objektivi kryesor i këtij plan veprimi energjisë efiçiente dmth konsumimi i energjisë elektrike, që duhet të kemi sa më pak konsumim të energjisë. Nëse keni ndonjë diçka që ju intereson dmth që të gjitha komunat në bazë të ligjit duhet me e pas.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: ka ndonjë diçka po Burim

Burim Bujupi; Meqë është ligj dhe duhet votuar normal që në parim jemi për, them se duhet me pas sa më sukses.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj; Meqë nuk ka më diskutime kalojmë në votim të kësaj pike. Votojmë; *7 për, kundër s'ka, abstënim s'ka. Miratohet.*

Vazhdojmë me pikën 3; Raporti financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar- Shtator 2019. Këtu ia kisha kaluar fjalën drejtorit për Buxhet dhe Financa, që në pika të shkurtra të na bëjë një prezantim.

Drejtori për buxhet dhe financa Shyqiri Bublaku; Për hartimin e raportit financiar të zhvillimit të buxhetit është mbështetur në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, dmth neni 45 ku kryetari i Komunës duhet të hartojë çdo tre mujor një raport për zhvillimin e financave komunale sipas periudhës aktuale, periudha e caktum është nga janari në shtator. Në rastin konkret qëllimi i këtij raporti është që të njoftohet bordi i financave të kuvendit, të gjitha mediat elektronike dhe të shkrume, për tu njohur me shpenzimet e financave publike për periudhën janar-shtator 2019. Më tej drejtori i financave vijoi njoftimin e komitetit me shifra konkrete.

Kryetari Ramiz Lladrovci; Unë desha me shtu dhe sqaru Komitetin për Politik dhe Financa edhe pse ne jemi mirë në shpenzim parash nuk do të thotë se do të jemi mirë deri në fund. Tash do kemi edhe probleme pasi tash qeveria në dorëheqje, qeveria në themelim me na dhanë qasjen e mjaftueshme, ashtu siç na i kanë dhënë në vitet e tjera. Unë kam një frikë se nuk do të mund ti arrijmë shpenzimet siç duhet, por ajo që dua të paktën ta kalojmë 75% që të mund të marrim grante, të cilat ne vetëm sivjet i kemi fitu si rezultat ; shpenzimit të mirë të parasë publike dhe performancës së mire dhe kemi fituar afërsisht 1 milion euro grante shtesë. Po kjo s'do me thënë se kemi për ti kalu mirë deri në fund. Ndikojnë shumë gjëra. Çështja e Drejtorit të Infrastrukturës ndikon dhe shumë sende të tjera ndikojnë po këto janë procese që bien veç mbi mu.


Burim Bujupi; Faleminderit drejtor desha mu ndal pak tek fjala e kryetarit që tha duke u ndalur në vitin 2018 dhe 2019 shfrytëzimi i mjeteve të ndara ne jemi më mire për 12% performance më lartë ka bërë komuna. Vjet kemi qenë në shpenzime të mjeteve diku 82%. Duke marrë parasysh këto premisa duket se do të jemi më mirë, por desha me dijtë çfarë ka ndodhur me ndalimin e punimeve që ka ndërmarrë Drejtoria e Infrastrukturës pse janë ndërprerë.

Kryetari Ramiz Lladrovci; I dashur Burim! Para se me nis mbledhjen folëm shumë për çështjet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe për problemet që i ka pas Komuna me Ministrinë e Infrastrukturës. Ata po provojnë me na u hakmarrë me projektet e Drenasit pse nuk i kemi lenë me çelë tendera sipas dëshirës së tyre dhe në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve të Drenasit dhe shërbimeve ndaj qytetarëve. Na në rregull jemi duke e ba trotuarin në rrugën regjionale Drenas – Malisheve, punimet në Arllat. Ata na i kanë blloku punimet pse ne nuk kemi kërkuar një pëlqim prej tyre. Kemi ba kërkesën për pëlqim, na vonojnë aq sa dëshirojnë dhe sa mujn me pas mundësi me na vonu, pastaj një ditë do kontrollojnë dokumentat dhe afatet dhe s'kanë qare pa na e miratu kërkesën tonë sepse ato janë punë në shërbim të qytetarëve dhe nuk e pengojmë fare komunikacionin por përkundrazi e sigurojmë atë duke ndërtuar trotuarin në Arllat. Njëjtë po veprojnë edhe në Qyqavicë edhe do vende të tjera . Agjencioni i Pyjeve na ka ndalur punimet dhe tash i kemi pëlqimet e tri komunave, që ne dona me e zhvillu atë rrugë. Ata na vonojnë që ne të mos kemi kohë të shfrytëzojmë buxhetin dhe realizimin e këtyre punimeve.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj; Atëherë meqë nuk ka më diskutime, raporti kalon në kuvend për diskutim.

Kalojmë tek pika e fundit; të ndryshme. Nuk ka diskutime atëherë mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Procesmbajtëses


Zahrie Podrimqaku- Subashi



Kryesuesi i Kuvendit


Labinot Halilaj